



Prishtinë: 12.10.2012

Kodi i ZRRE-së: V\_480\_2012

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK\_V\_803\_06\_12

### Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kreut IV, nenit 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë e paraqitura nga palët;
4. Vendimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_803\_06\_12**; dhe
5. Ankesën e KEK-ut me datë 09.07.2012.

**Në mbledhjen e mbajtur më 12 tetor 2012 nxori këtë:**

### VENDIM

- I **REFUZOHET** ankesa e KEK-ut ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin V. L. (shifra në KEK: DPR - 90024921 ), nga Prishtina, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK\_V\_803\_06\_12 i datës 05.06.2012.

### Arsyetim

Punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikave matëse me datë 15.04.2008 kanë bërë inspektimin e pikës matëse të konsumatorit, ku kanë theksuar se konsumatori ka bërë ndërrim njehsori përkatësisht ka larguar nga matja njehsori elektrik nr. 327778743 dhe kanë vendosur për matje njehsori elektrik nr. 44150074, si dhe kanë konstatuar se këtij njehsori i mungon kapaku dhe se tre urat e tensionit janë të larguara andaj furnizohet pa matje.

Departamenti për Faturim në KEK me datë 18.04.2008 e ka ngarkuar konsumatorin me shfrytëzim të paautorizuar fatura DPR08HP05373 në vlerë prej 11,622.69€. Pas ngarkesës së KEK-ut për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike në vlerë prej 11,622.69€, konsumatori ka parashtruar ankesë KEK. Departamenti për Konsumator në KEK ka shqyrtuar lëndën e konsumatorit ku edhe ka refuzuar ankesën e tij. Konsumatori pas marrjes së përgjigjes nga ana e KEK-ut, brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE me të cilin ka kundërshtuar ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike.

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE ka bërë shqyrtimin e ankesës së konsumatorit dhe me datë 05.06.2012 ka nxjerr vendim duke **refuzuar pjesërisht** ankesën e konsumatorit dhe duke kërkuar nga KEK-u që të shkarkoj konsumatorin nga fatura e shfrytëzimit të paautorizuar (rikthimit të humbjeve) DPR08HP05373 në vlerë prej 11,622.69€, si dhe të ngarkoj konsumatorin me faturë të rikthimit të humbjeve për periudhën 11 (njëmbëdhjetë) mujore duke marrë për bazë mesataren mujore prej 3,370 kWh/muaj.



Pas marrjes së vendimit të DMK-së me datë 28.06.2012 KEK-u ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRRE-së ndaj këtij vendimi, me të cilën ka kundërshtuar në tërësi vendimin e DMK-së nr. **ZRRE/DMK\_V\_803\_06\_12** të datës 05.06.2012, pasi që KEK, ka prezantuar një aktgjykim të nxjerr nga Gjykata Komunale në Prishtinë me të cilin gjykata ka vërtetuar te gjithë borxhin si rikthimi i humbjeve si dhe njëherit ka propozuar që të aprovohet kundërshtimi i KEK-ut dhe borxhi i theksuar më sipër të ngelet kontest deri në përfundimin e të gjitha procedurave ligjore.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 12 tetor 2012 ka analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e KEK-ut, përkatësisht bazën e kundërshtimit aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë P.nr.993/08 i datës 24.03.2009, i cili vendim është i formës së prerë.

Bordi i ZRRE-së pas shqyrtimit dhe analizimit të lëndës së konsumatorit si dhe duke marr për bazë edhe aktgjykimin e nxjerr nga ana e Gjykatës ka vërejt se konsumatori ka bërë shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike duke bërë largimin e urave të tensionit nga pika matëse gjegjësisht njehsori elektrik dhe duke i marr për bazë të gjitha këto ka refuzuar pjesërisht ankesën e konsumatorit.

Bordi i ZRRE-së konsideron se konsumatori ka bërë shkelje të dispozitave të nenit 4 pika a) të Procedurës së përkohshme për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike, ku më këtë rast është bërë furnizimi me energji nga ana e konsumatorit duke e anashkaluar matjen e energjisë elektrike nëpërmjet njehsorit elektrik.

Bordi i ZRRE-së duke i marrë për bazë të dhënat e cekura më lartë konstaton se KEK në momentin e konstatimit të gjendjes se konsumatori ka bërë shfrytëzim të paautorizuar të energjisë nuk ka vepruar konform dispozitave të nenit 12 të Procedurës së përkohshme për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike. Pasi që në këtë rast KEK-u, ka gabuar në llogaritjen e faturës së rikthimit të humbjeve ngase dispozitat e këtij neni theksojnë që kalkulimi i faturës për konsumatorët jo shtëpiak duhet të bëhet në bazë të pajisjeve që i posedon konsumatori e jo të merret për bazë kalkulimi në bazë të seksionit të kabullit. Andaj Bordi i ZRRE-së, konsideron se konsumatori ka bërë shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike ku nëpërmjet saj i ka shkaktuar edhe dëm KEK-ut, mirëpo kundërshton mënyrën e kalkulimit të bërë nga ana e Departamentit të faturimit të KEK, që bie në kundërshtim me procedurën e cekur më lart.

Bordi i ZRRE-së ka vlerësuar se KEK në ankesën e tij nuk ka prezantuar asnjë provë të vetme me të cilën e vërteton faktin se vendimi i DMK-së nuk është i drejtë dhe i bazuar në ligj, gjithashtu ankesa e KEK-ut, nuk i përmban elementet bazë të një ankese pasi që është shumë e mangët për kah përmbajtja. Kundërshtimet që janë dhënë në ankesë nuk i referohen se cilat dispozita ligjore janë shkelë nga ana e DMK-së, gjatë nxjerrjes së vendimit, por që KEK vetëm është thirr në formën e përgjithësuar.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 12.10.2012 ka analizuar ankesën e KEK-ut dhe vendimin e nxjerrë nga ana e DMK-së nr. ZRRE/DMK\_V\_803\_06\_12, dhe pas analizimit të hollësishëm të të gjitha dëshmimeve tjera të prezantuara në shkresat e lëndës ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.



**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

**Bordi i ZRRE-së**

---

Enver Halimi, kryesues

---

Përparim Kabashi, anëtar

---

Blerim Koci, anëtar

---

Merita Kostari, anëtare

---

Krenar Bujupi, anëtar